



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 14.07.2025
Numër Protokolli: 5518/2025

A.nr.978/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.978/2025, të datës 27.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit: Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 14.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.978/2025, e datës 27.05.2025, e parashtruar nga ankuesi, G.H.
- II. **Mbetet në fuqi** Njoftimi me numër protokolli 01-03-603, i datës 15.05.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, lidhur me shpalljen e rezultatit përfundimtar në procedurën e pranimit më numër të refercës RN00017115, pozita Zyrtar për Statistika të Tregut të Punës si dhe Njoftimi (pa datë) i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, G.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 27.05.2025, përmes emailit, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me parregullsitë e ndodhura në konkursin me Nr. Ref: RN00017115, për Grupin e Statistikës, pozita Zyrtar për Statistika të Tregut të Punës, i shpallur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Statistikave të Kosovës (tutje ASK), ndërsa, kjo e fundit, me datë 10.06.2025, ka dorëzuar vetëm provat materiale lidhur me çështjen në procedurë ankimore, duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) si prova i administroi: Ankesën me numër protokolli 3527/2025 të datës 27.05.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Nr. Reference: RN00017115, për Grupin e Statistikës, për pozitën e punës “Zyrtar për Statistika të Tregut të Punës”; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 10.06.2025; Njoftimin për refuzimin e aplikacionit; Listën e aplikantëve; Njoftimin për listë të ngushtë i datës 23.04.2025; Vendimin e datës 23.04.2025 për emërimin e Komisionit të Pranimit dhe akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të pranimit; Njoftimin e datës 15.05.2025 për rezultatet përfundimtare; Aplikacionin e datës 17.03.2025 të kandidati D.Gj me dokumentacionin nga faqe 1-17; Aplikacionin e ankuesit i datës 15.03.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-30; Vendimin me numër protokolli 4640/2025 të datës 10.07.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton kjo gjendje faktike:

-ASK-ja më datë 14.03.2025, ka shpallur Konkursin me Nr. Ref: RN00017115, për Grupin e Statistikës, për pozitën e punës “Zyrtar për Statistika të Tregut të Punës”, klasa e pozitës profesional 2, me afat aplikimi 15.03.2025 deri 13.04.2025.

-Ne këtë procedurë konkurrimi kanë aplikuar tridhjetë (30) kandidatë, përfshirë edhe ankuesin, mirëpo ankuesit i ishte refuzuar aplikacioni më arsyetimin se i njëjti nuk ka plotësuar kriterin e arsimit.

- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të ASK-së, më datë 15.05.2025, ka publikuar njoftimin me numër protokolli 01-03-603, për rezultatet përfundimtare, e sipas të cilit njoftim rezulton së si kandidat me më së shumti pikë rezulton të jetë D.Gj me gjithsej 94.8 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se konkursi ka qenë i paqartë pasi që nuk është përcaktuar vendi apo lokacioni i punës. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet konkursi.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar atin e shpalljes së konkursit me Nr. Reference: RN00017115, për Grupin e Statistikës, pozitën e punës “Zyrtar për Statistika të Tregut të Punës”, she si pasojë ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme formale lidhur me pozitën e shpallur janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor) në fushat: Ekonomik, Matematikë, Gjeografi. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës, e për rrjedhojë Kolegji vlerëson se konkursi është shpallur sipas kritereve për grupin e përcaktuar në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Rrjedhimisht, Kolegji lidhur me këtë çështje juridike, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*

-nenit 39 paragrafi 1, dhe 7, ku përcaktohet: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.*

Andaj, referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji ka analizuar provat materiale lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit, gjegjësisht ka shqyrtuar Njoftimin e Njësisë përgjegjëse për refuzim të aplikacionit të ankuesit në ndërlidhje me dokumentacionin që ankuesi ka dorëzuar më rastin e aplikimit në këtë konkurs, dhe si rrjedhojë, Kolegji ka konstatuar se ankuesi lidhur me kriterin e arsimit ka ofruar si dëshmi Diplomën nr. 1349, të datës 05.11.2020, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për përfundim e studimeve themelore më datë 16.10.2020, në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, duke marr titullin Baçelor në Ekonomia e Bujqësisë, pra, mbi gjendjen e kësaj dëshmie rrjedhë se ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e fushës së arsimit lidhur me pozitën përkatëse, sepse, fusha e studimeve të ankuesit nuk përputhet me kualifikimin e kërkuar sipas konkursit e ku kërkohej Ekonomik, Matematikë, Gjeografi, andaj, edhe pretendimi ankimor i ankuesit mbi këtë shkak është i pabazuar, kështu që, Njësia e Burimeve Njerëzore të ASK-ës me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike duke vepruar në pajtim me nenin 39 paragrafi 7 pika 7.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Rrjedhimisht, nisur nga mandati kushtetues dhe ligjor i KPSHCK lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, Kolegji ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë edhe veprimet administrative të ndërmarra në fazën e vlerësimit profesional përkitazi me procedurën më nr. ref:RN00017115, nga dhe nuk ka gjetur ndonjë shkelje esenciale ligjore që si të tilla do e cenonin legjitimitetin e procedurës së kontestuar.

Në ndërlidhje me konstatimin si më lart, e në mbështetje të respektimit të parimit të meritokracisë si një nga parimet bazë për pranim në shërbim civil, Kolegji i Këshillit ka analizuar aplikacionin e datës 17.03.2025, të kandidatit fitues D.Gj së bashku më dëshmitë përcjellëse ku dhe ka gjetur së i njëjti posedon Diplomën me Nr.13387 të datës 01.02.2024, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, më të cilin dëshmohet se më datës 03.11.2006, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik, duke marr titullin Baçelor ne Banka, Financa dhe Kontabilitet. Ndërsa, sa i përket kriterit të përvojës një (1) vjeçare të punës, kandidati në fjalë ka bashkangjitur Marrëveshjet për angazhim në praktikë në punë dhe atë marrëveshjen me nr.prot.60 të datës 04.03.2024 dhe marrëveshjen nr. protokolli

05.03.2022, më të cilat dëshmohet se nga data 04.03.2024 deri më datë 04.09.2025 është i angazhuar si praktikante në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, kështu që, i njëjti deri me datën e aplikimit ka një vit përvojë pune dhe mbi këtë bazë rrjedhë së i njëjti ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkursin e kontestuar, e duke qenë kandidati D.Gj ka arritur numrin më të madh të pikëve, atëherë, më të drejtë njësia përgjegjëse, në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore në ASK, e ka shpallur si kandidat fitues për procedurën me numër reference Nr. Ref: RN00017115, duke vepruar në pajtim më nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë së nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me numër reference . Ref: RN00017115, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.978/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit G.H;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në ASK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.